

AKT THEMELIMI

Për krijimin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar
"ENT-HNS" Shpk

KREU I

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Në bazë të ligjit nr.9901, datë 14.04.208 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Indryshuar, Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Kodit Civil në fuqi dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë që rregullon ligjshmérinë e shoqërive tregtare:

Z. **ALFRED AGA**, lindur në Peshkopi, i datës 18/03/1982, identikuar me kartë identiteti me nr.personal I20318057Q, , banues në Tiranë; Rruga e Dafinave, nr.73, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me vullnetin e tij të plotë dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar, vendos të themelojë shoqerinë me përgjegjësi të kufizuar "**ENT-HNS" Shpk**.

KREU II

EMRI, FORMA, OBJEKTI, SELIA, KOZGJATJA

Neni 1

Data e themelimit dhe Emri

1.1 Sot në datë 11 Shtator 2024, krijohet Shoqëria me emërtimin "**ENT-HNS" Shpk** (në vijim Shoqëria) e ndekur në mënyrë të pandashme nga shkurtimi Shpk, e sila përfaqëson formën ligjore të saj, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

1.2 Ortakët e Shoqërisë ("Ortakët") gëzojnë përgjegjësi të kufizuar deri në limitin e kontributit përkatës në kapitalin e shoqërisë të përfaqësuar në kuota.

Neni 2

Forma ligjore dhe personaliteti juridik

2.1 Shoqëria "**ENT-HNS" Shpk**, është një entitet Shqiptar, dhe ka formën ligjore të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar ("Shpk"), në përputhje me ligjin Nr.9910, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" ("Ligji I Shoqërise").

2.2 Shoqëria fiton personalitet juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me procedurat e parashikuara në ligj.

2.3 Për detyrimet që do të krijohen ndaj personave të tretë gjatë aktivitetit të kësaj shoqërie, do të përgjigjet vetë shoqëria deri në kufirin maksimal të kapitalit të saj.


1

Neni 3

Selia, Adresa

3.1 Selia qëndrore e shoqërisë "**ENT-HNS Shpk**", ndodhet në adresën: Rruga e Dafinave, nr. 73, 1023, Tiranë.

3.2 Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë selinë e saj në një adresën dhe/ose në një qytet tjetër të Shqipërisë. Shoqëria mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë

3.3 Statuti I shoqërisë I bashkangjitët këtij akti themelimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3.4 Shoqëria ka vulen e saj me logon dhe të dhënrat të përcaktuara.

Neni 4

Objekti

4.1 Shoqëria "**ENT-HNS Shpk**" mund të kryejë cdo aktivitet tregtar të lejuar nga legjislacioni Shqiptar, dhe në vecanti do të ketë për objekt të veprimtarisë:

- Shërbime dhe konsulenca mjekësore të përgjithshme dhe të specializuara
- Import-export I materialeve dhe aparaturave mjekësore, produkteve shëndetësore si integratorë dhe kozmetike, pajisje dhe aparate mjekësore me interes shëndetësor.
- Shitje dhe blerje me shumicë dhe pakicë të pajisjeve dhe materialeve mjekësore.
- Investime në fushën e kërkimeve mjekësore dhe trajnime për formim profesional.

4.2 Për arritjen e qëllimeve të lartpërmendura, shoqëria mund të kryejë të gjitha veprimet e kërkua, me gjykimin e vetëm të organit administrativ për zbatimin e objektit të shoqërisë.

4.3 Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë, të zgjerojë objektin e veprimtarisë së saj në cdo moment, duke u bazuar në statut dhe duke ndjekur hapat proceduriale bazuar në legjislacionin në fuqi.

Neni 5

Kohëzgjatja

5.1 Shoqëria fiton personalitetin juridik në datën e regjistrimit pranë Qëndrës Kombëtare të Biznesit dhe nga kjo datë ajo mund të fillojë të ushtruje aktivitetin tregtar.

5.2 Shoqëria "**ENT-HNS Shpk**" kryen veprimtarinë e saj tregtare për një periudhë kohore të pacaktuar.

5.3 Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme vendoset pezullimi apo cregjistrimi I shoqërisë ose kur Shoqëria mbaron së ushtruari aktivitetin e saj, në një nga mënyrat e parashikuara në ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

KREU III

KAPITALI THEMELTAR, ORGANET E SHOQERISE

Neni 6

Vlera e kapitalit të regjistruar, kuotat

6.1 Kontributi I ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtëshme/të paluajtëshme apo të drejta).

6.2 Ortakët përgjigjen për humbjet e shoqërisë përkudndrejt të tretëve deri në vlerën e kontributeve të tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë.

6.3 Kapitali I Shoqërisë është i shprehur në kapital në para, në vlerën 10,000 (Dhjetë mijë) Lekë.

6.4 Kapitali I mësipërm është nënshkruar dhe do të shlyhet apo të hapen llogaritë bankare të shoqërisë nga

ortakë

6.5 Ortakët e shoqërisë dhe kuotat e zotëruara prej tyre në Shoqëri janë si më poshtë:

Z. **Alfred Aga**, lindur në Peshkopi, i datëlindjes 18/03/1982, identifikuar me kartë identiteti me nr. personal 120318057Q, banues në Tiranë; Rruga e Dafinave, nr.73, është ortak I vetëm I shoqërisë "ENT-HNS" Shpk, I cili zoteron një kuotë me vlerë 10,000 (dhjetë mijë) Lekë që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 7

Organet Vendimarrëse – Asambleja e Përgjithshme

7.1 Asambleja e Përgjithëshme e Ortakëve është organi I vetëm vendimarrës I shoqërisë, I cili drejton dhe merr vendimet mbi aktivitetin dhe politikat e saj ekonomike dhe tregtarie.

7.2 Asambleja e Përgjithëshme e Ortakëve është organi vendimarrës I shoqërisë që miraton edo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

7.3 Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 8

Të drejtat dhe Detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme

8.1 Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqerinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statute.

8.2 Nëse shoqëria zotërohet nga një ortak i vetëm, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm dhe të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënët e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Neni 9

Organet administrative të Shoqërisë

9.1 Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë

9.2 Administratori i vetëm i shoqërisë do të jetë **Z. Alfred Aga**, I biri I Flamurit, shtetas Shqiptar, me numër personal identifikimi I20318057Q, i datëlindjes 18/03/1982, lindur në Peshkopi (Djbër) dhe banues në Tiranë, me afat emërimi 5 vjeçar, duke filluar nga data e emërimit me të drejtë riemërtimi, sipas ligjit në fuqi.

9.3 Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë.

Administrator i shoqërisë mund të emërohet edhe një person i tretë jashtë ortakërisë.

9.4 Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Statuti mund të vendosë rregulla të posaçme për emërimin e administratorëve.

Neni 10

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Administratorëve

10.1 Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

b) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

c) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rr Ethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënët e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut

f) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;

10.2 Administratori (ët) detyrohen te veprojnë me besnikëri dhe me mirëbesim si:

a) Të kryejë detyrat e tyre e përcaktuara në ligj ose në këtë status në miëbesim e në interest ë mirë të shoqërisë në tërsi, duke I kushtuar vëmendje të vecantë ndikimit të veprimtarisë së Shoqërisë në mëdis,

- b) Të ushtrojë kompetenca që u njihen me ligj ose nga ky statut, vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita,
- c) Të vlerësojë me pernjegjësi cështjet për të cilat merret vendim,
- d) Të ushtrojë detyrat e tyre me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm
- e) Të parandalojë dhe të mënjanojë rastet e konfliktit, present apo mundshëm, të interesave personale me ato të Shoqërisë.

10.3 Nëse Asambleja e Përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë. Administratori mund të delegojë kryerjen e detyrave të administrimit tek një person I tretë edhe jashtë shoqërisë.

10.4 Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Neni 11

Viti finanziar dhe shpëndarja e fitimit

11.1 Cdo vit finanziar fillon më 1 janar dhe mbylltet me 31 dhjetor. Përjashtim bën viti I parë finanziar I cili fillon në datën e regjistrimit të shqërisë dhe përfundon më 31 dhjetor të atij viti.

11.2 LLogaritë kontabël, dokumentacioni, principet dhe të gjitha veprimet kontabël do të kryen bazuar në Standartet Kombëtare/Ndërkombëtare të Kontabilitetit, dhe dispozitave ligjore në fuqi që lidhen me procedurat e hartimit dhe deklarimit të raporteve financiare.

11.3 Nëse është e nevojshme ose kërkohet nga ligji në fuqi, kontrolli I raporteve financiare të shoqërisë I besohen një eksperti kontabël të autorizuar, të emëruar nga Asambleja e Ortakëve.

11.4 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë, në raport me kuotat e zotëruara.

Neni 12


Dispozita përfundimtare

12.1 Dispozita të hollësishme mbi organizimin e kësaj shoqërie përcaktohet në statutin e saj si akt I pandashëm I këtij akt themelimi.

12.2 Themeluesit e kësaj shoqërie, të redaktuar ne 2 (dy) ekzemplarë, pasi, e lexuan me vëmendje këtë akt themelimi dhe e gjetën në përputhje me legjislacionin ne fuqi dhe me vullnetin e tyre të lië, e firmosën pa vërejtje.

**ORTAKU I VETËM
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ENT-HNS” shpk**

ALFRED AGA



(Emër, Mbiemër, Nënshtaktimi)